



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 101 Prot.

Tiranë, më 10.02.2017

V E N D I M

Nr. 23, datë 10.02.2017

“Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr.83, datë 20.07.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga Bashkia Përmet, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 27.04.2016 e në vazhdim”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civil, nxjerr vendime paralajmëruese në rast se konstaton parregullsi dhe përcakton detyra konkrete për rregullimin e situatës.

Për këtë arsye:

Në zbatim të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11/1 dhe 14 , të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenit 34 e vijues të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues nr. 83, datë 20.07.2016, të Komisionerit, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin e Bashkisë Përmet, prej datës 27.04.2016 (*momenti i përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit mbi bazën e të cilave u analizua situata në shërbimin civil gjatë mbikëqyrjes*) e në vazhdim,

VENDOSA:

1. Fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 83, datë 20.07.2016, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr.333., Prot, datë 18.04.2016”.
2. Verifikimin e akteve të emërimit, të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke mosrespektuar procedurat e rekrutimit, në institucionin Bashkia Përmet, prej datës 27.04.2016 (*momenti i përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit mbi bazën e të cilave u analizua situata në shërbimin civil*) e në vazhdim,

sipas objektit dhe aneksit që përmban Programi i Verifikimit, i cili është pjesë e këtij vendimi.

3. Ngritjen e grupit të punës, me këtë përbërje:

1. Altin Shumeli	Drejtor i Mbikëqyrjes
2. Saimir Muçmataj	Inspektor, Drejtoria e Mbikëqyrjes
3. Joni Marko	Specialist, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë

4. Ky proces do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt, në datat **13.02.2017 - 16.02.2017** dhe do të përfundojë më datën **02.03.2017**.
5. Me përfundimin e verifikimit të akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave në subjekt, grupi i punës, do të vijojë punën me përpunimin e të dhënave. Aktet e konstatimit, procesverbalet e mbajtura në subjekt si dhe dokumentacioni i administruar, lidhur me zbatimin e vendimit të Komisionerit dhe verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve të kryera nga institucioni, do t'i paraqiten për të vijuar procesin respektivisht Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit, brenda datës **20.02.2017**. Relacionet përkatëse duhet të përpilohen deri në datën **27.02.2017**. Më pas do t'i paraqiten për miratim Komisionerit, dhe më tej, do të hartohen vendimet për përmbylljen e proceseve, brenda **3** ditëve.
6. Vendimi përfundimtar dhe vendimi paralajmëruar i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për përmbylljen e procedimit administrativ (*verifikimit*) do t'i dërgohet subjektit të mbikëqyrur Bashkia Përmet.
7. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit dhe Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, që të marrin masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me nenin 42, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi Zogu I-rë, Godina 57, shk.2, Nr.18. Tiranë

Tel: 355 4 2268 141; Fax: 355 4 2268 142

Nr. 101/1 Prot.

Tiranë, 10.02.2017

M I R A T O H E T

Pranvera STRAKOSHA

KOMISIONER

PROGRAM VERIFIKIMI

(Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 83, datë 20/07/2016, dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga institucioni Bashkia Përmet, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 27.04.2016 e në vazhdim).

1. Subjekti i mbikëqyrjes: Bashkia Përmet

2. Objekti i verifikimit: Zbatimi i Vendimit paralajmërues nr. 83, datë 20.07.2016, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr.333., Prot, datë 18.04.2016”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Verifikimi i akteve të emërimit, të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke mosrespektuar procedurat e rekrutimit, në Bashkinë Përmet prej datës **27.04.2016** (momenti i përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit mbi bazën e të cilave u analizua situata në shërbimin civil gjatë mbikëqyrjes) e në vazhdim.

3. Baza ligjore: Neni 14, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe neni 34 e vijues i rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me

Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

4. Periudha e verifikimit:

Fillon me datën e daljes së Vendimit paralajmërues të Komisionerit nr. 83, datë 20.07.2016 “*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr.333., Prot, datë 18.04.2016*”, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi dhe në datën e përfundimit të mbikëqyrjes në subjekt (27.04.2016), për rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin.

5. Afati i verifikimit:

Verifikimi do të fillojë në institucion në datat **13.02.2017 - 16.02.2017** dhe do të përfundojë brenda datës **02.03.2017**.

6. Procedura që do të ndiqet:

Për parregullsitë e konstatuara do të mbahen aktet e konstatimit, procesverbal administrativ, të cilët do të nënshkruhen nga grupi i verifikimit dhe personat përgjegjës, si dhe do të merret kopja e dokumentacionit përkatës, vërtetuar nga sekretaria e institucionit.

7. Grupi i punës:

1. Altin Shumeli Drejtor i Mbikëqyrjes
2. Saimir Muçmataj Inspektor, Drejtoria e Mbikëqyrjes
3. Joni Marko Specialist, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë

8. Dokumentimi i rezultateve të verifikimit:

Në përfundim të procesit të verifikimit dhe mbikëqyrjes do të përgatiten relacionet përkatëse nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit, bazuar në aktet e konstatimit dhe procesverbalet e mbajtuara në subjektin e verifikuar si dhe do të administrohet dokumentacioni provues. Më pas do të hartohet vendimi përfundimtar i procedurave përmbyllëse të verifikimit të zbatimit të vendimit, i cili do të dërgohet institucionit (*n.q.s vendimi nuk është zbatuar, Komisioneri do të zbatojë kompetencën e parashikuar në nenin 15, pika 2, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar*) dhe vendimi paralajmërues në përfundim të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative lidhur me emërimet e dala në kundërshtim me ligjin.

DREJTIMET E VERIFIKIMIT

I. Si janë zbatuar, detyrat e lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Vendimin nr. 83, datë 20.07.2016 “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr.333., Prot, datë 18.04.2016”, nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit të mbikëqyrur. Në këtë rast, verifikimi do të realizohet duke pasur parasysh nivelin e zbatimit të urdhërimeve në vendimin paralajmërues, si më poshtë, duke administruar kopje të akteve që materializojnë zbatimin e vendimit:

“1. Të kërkojë nga organi kompetent, të miratojë strukturën përfundimtare, organikën e kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil, të bashkisë dhe njësive administrative në varësi të bashkisë, në përputhje me vendimin nr. 06, datë 04.03.2016, të Këshillit të Bashkisë Përmet, “Për Miratimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2016 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve dhe Njësive Administrative në varësi të saj”.

2. Mbas miratimit të strukturës përfundimtare nga Kryetari i Bashkisë Përmet, njësia përgjegjëse të përcaktojë pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil në bashki dhe në njësitë administrative në varësi të saj, duke u bazuar në funksionet dhe detyrat konkrete të vendeve të punës përkatëse, të përcaktuara në formularin e përshkrimit të punës, të cilat ushtrojnë funksione publike, duke përjashtuar rastet e përcaktuara në nenin 2, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Ky proces duhet të materializohet në strukturën e institucionit që do të miratohet nga Kryetari i Bashkisë Përmet, duke u specifikuar në mënyrë të shprehur “Pozicion pune në shërbimin civil”.

3. Njësia përgjegjëse të kryejë verifikimin e marrëdhënieve të punës së personelit ekzistues të Bashkisë Përmet dhe Njësive Administrative në varësi të saj (ish-Komunave), nëse ka raste kur ata kanë qenë të punësuar në pozicione pune pjesë të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014).

Pas përfundimit të procesit të verifikimit të marrëdhënieve të punës së personelit ekzistues, njësia përgjegjëse duhet të vijojë me procesin e deklarimit të statusit të punësimit për punonjësit që i plotësojnë kushtet për të qenë nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

4. Njësia përgjegjëse, të revokojë aktet administrative, të cilët kanë dalë në kundërshtim me ligjin, për emërimin e përkohshëm të 22 punonjësve, si më poshtë:

1. Të revokojë aktin administrativ nr. 22, datë 05.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Përgjegjës administrate”;
2. Të revokojë aktin administrativ nr. 78, datë 07.12.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist i Trashëgimisë Kulturore”;
3. Të revokojë aktin administrativ nr. 74, datë 07.12.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist PAK”;
4. Të revokojë aktin administrativ nr. 58, datë 02.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist Taksash”;
5. Të revokojë aktin administrativ nr. 45, datë 16.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist Informacioni, Statistike dhe Media”;
6. Të revokojë aktin administrativ nr. 38, datë 16.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist Shërbimesh”;
7. Të revokojë aktin administrativ nr. 34, datë 09.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist i Ndhmës Ekonomike”;
8. Të revokojë aktin administrativ nr. 121, datë 11.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist Urbanistike”;
9. Të revokojë aktin administrativ nr. 120, datë 08.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Jurist”;
10. Të revokojë aktin administrativ nr. 104, datë 31.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist Taksash”;
11. Të revokojë aktin administrativ nr. 96, datë 31.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Juriste”;
12. Të revokojë aktin administrativ nr. 82, datë 21.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Inspektor Mjedisi”;
13. Të revokojë aktin administrativ nr. 81, datë 21.3.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Inspektor Mjedisi”;
14. Të revokojë aktin administrativ nr. 78, datë 21.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist Finance”;
15. Të revokojë aktin administrativ nr. 67, datë 21.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist Projektsh në Urbanistik”;
16. Të revokojë aktin administrativ nr. 62, datë 21.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist Urbanistike”;
17. Të revokojë aktin administrativ nr. 60, datë 21.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Përgjegjës Zyrës Arsimore”;
18. Të revokojë aktin administrativ nr. 59, datë 21.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialiste Muzeu”;
19. Të revokojë aktin administrativ nr. 42, datë 15.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialit urbanistike”;
20. Të revokojë aktin administrativ nr. 34, datë 15.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist Shëndetësie”;
21. Të revokojë aktin administrativ nr. 10 datë 01.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”;

22. Të revokojë aktin administrativ nr. 6, datë 14.01.2016, të Kryetarit të Bashkisë Përmet, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Specialist i Ndhmës Ekonomike PAK”.
5. Njësia përgjegjëse, të miratojë planin vjetor të pranimeve në shërbim civil, për vitin 2016 sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimin në shërbimin civil”, si dhe ta publikojë atë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të bashkisë dhe në stendat për njoftime publike të institucionit.
6. Njësia përgjegjëse, të plotësojë pozicionet e punës që mbeten të lira, me anën e procedurave të konkurrimit të hapur sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, si procedura që përfaqësojnë sistemin e karrierës në shërbimin civil.
7. Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike. Në veçanti, njësia përgjegjëse të kujdeset për të respektuar kërkesat ligjore në procedurat si më poshtë:
- a) Të krijohen Komisionet përkatëse të pranimin dhe vlerësimit (Komiteti i Përhershëm i Pranimin për nivelin ekzekutiv, Komiteti për Lëvizjen Paralele dhe Ngritjen në Detyrë) sipas procedurës që do të ndjekë për të plotësuar pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil. Komisioni i vlerësimit ka për detyrë të kryejë vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim, i cili konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit, vlerësimin me shkrim (përveç lëvizjes paralele) dhe vlerësimin në intervistën e strukturuar me gojë.
- b) Të bëjë publike në faqen zyrtare, “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të Bashkisë Përmet, ose nëse është e mundur, në stendat për publikun, shpalljet si:
- Aktin e shpalljes për të plotësuar një pozicion të lirë pune në shërbimin civil. Të tregohet kujdes që ky akt të përmbajë të dhënat, e përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, e pikën 5, Kreu III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; pranim në shërbim civil; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimin (arsimi i lartë përkatës); dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së

kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjor që duhet të përmbajë shpallja.

- Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele” ashtu edhe për fazën e dytë “pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”.
- Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht (lista përfundimtare) për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele” ashtu edhe për fazën e dytë “pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”.
- Aktin e shpalljes së kandidatit të nxjerrë fitues me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.

8. *Njësia përgjegjëse e Bashkisë Përmet, të zbatojë vendimin brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me aktet përkatëse, që materializojnë veprimet administrative përkatëse, për zbatimin e këtij vendimi.”*

Në rast të konstatimit të moszbatimit të pjesshëm apo të plotë të vendimit të Komisionerit, do të mbahet procesverbal konstatimi, i cili do të nënshkruhet nga grupi i punës dhe personi përgjegjës.

- II.** Verifikimi i ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera nga ky institucion, lidhur me emërimet të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke mos u respektuar procedurat e rekrutimit, duke filluar nga data 27.04.2016 (nga momenti i përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit mbi bazën e të cilave u analizua situata në shërbimin civil) e në vazhdim. Në rast të konstatimit të veprimeve të parregullta që kanë të bëjnë me këtë institut të ligjit, do të administrohen kopje të akteve, si dhe do të procedohet me procesverbal konstatimi, i cili do të nënshkruhet nga grupi i punës dhe personi përgjegjës.

Aneks i programit: Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit.

Në vijim të programit të verifikimit, më poshtë po rendisim aktet që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit për të përfunduar këtë proces.

1. Provat shkresore të cilat vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me vendimin paralajmërues.
2. Struktura organizative dhe analitike e institucionit që ka qenë në fuqi në momentin e mbikëqyrjes dhe ajo aktuale.
3. Listëpagesat dhe listëprezencat e institucionit, duke filluar nga momenti e mbikëqyrjes së mëparshme deri tek ato aktuale.
4. Aktet administrative të cilat materializojnë emërimet në kundërshtim me ligjin, (aktet e emërimit/ kontratat e përkohshme të punës).

5. Dosjet personale të nëpunësve të emëruar pas verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM
I INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

**DREJTORI I ÇËSHTJEVE JURIDIKE
DHE I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

Arbana BASHA

Enkelejda HEBIBASI